

V E N D I M
Nr.273, datë 12.6.1993

PËR RRITJEN E ÇMIMEVE TË BUKËS MASIVE DHE TË MIELLIT

Me propozimin e Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë, të Ministrisë së Bujqësisë e të Ushqimit dhe të Ministrisë së Tregtisë e të Bashkëpunimit Ekonomik me Jashtë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Çmimet e bukës masive dhe të miellit të grurit që përdoret për prodhimin e bukës masive, të miratuara me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.18, datë 11.1.1993, ndryshohen përkatësisht si vijon:

a) Bukë masive:

- Me miell gruri rreze	96%	21.7 lekë/kg
- “	90%	22.9 lekë/kg
- “	85%	24.2 lekë/kg
- “	80%	25.5 lekë/kg
- “	75%	28.7 lekë/kg

b) Miell gruri për bukë masive:

- Rreze 96%	22.6 lekë/kg
- “ 90%	23.7 lekë/kg
- “ 85%	24.6 lekë/kg
- “ 80%	25.8 lekë/kg
- “ 75%	29.6 lekë/kg

Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit, Ministria e Tregtisë dhe e Bashkëpunimit Ekonomik me Jashtë, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë, sipas standardeve shtetërore në fuqi, përcaktojnë çmimet e shumëfisheve dhe nënfishëve të këtyre artikujve, pa prekur nivelin bazë të çmimeve përkatëse të miratuara sipas kësaj pike.

2. Për artikujt, çmimet e të cilëve rriten sipas pikës 1 të këtij vendimi, diferencat ndërmjet çmimeve të reja dhe atyre të mëparshme derdhen detyrimisht në Buxhetin e Shtetit, për sasitë që janë furnizuar nga shteti dhe që do të jenë gjendje pranë ndërmarrjeve e njësive përkatëse të tregtisë (shtetërore ose private), në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Organet përkatëse të pushtetit lokal të kontrollojnë dhe të marrin masa për kryerjen e rregullt të inventarizimeve, sistemimin e diferencave të çmimeve dhe derdhen e tyre në buxhet.

3. Ministria e Financave dhe e Ekonomisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë e të Ushqimit, të përcaktojnë çmimet e shitjes së grurit dhe të miellit për familjet fshatare, në përputhje me çmimin e bukës masive dhe me vendin e dorëzimit, si dhe marzhet e grumbullimit, të trajtimit e të shpërndarjes së tyre.

Gjatë periudhës së korrjeve të vitit 1993, Buxheti i Shtetit do të përballojë interesat për kreditë që marrin ndërmarrjet shtetërore vetëm për grumbullimin e grurit, si dhe do të përballojë shpenzimet shtesë që do të përdoren në raste të veçanta për ritransportimin e grurit e të miellit nga një rreth në tjetrin, që rrjedhin nga mungesa furnizimi të paparashikuara.

Ministria e Financave dhe e Ekonomisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë e të Ushqimit, të nxjerrin udhëzim të veçantë për këtë pikë, si dhe lidhur me mënyrën e përballimit të këtyre shpenzimeve.

4. Ministria e Financave dhe e Ekonomisë, si dhe ministrinë e tjera, nxjerrin udhëzime dhe sqarime të tjera përkatëse në zbatim të këtij vendimi.

5. Çmimet dhe dispozitat e tjera që bien në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi më 1 korrik 1993.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

